# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-464534**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rritja e çmimeve të banesave u frenua në gjysmën e parë të 2026 |
| ADRESA | `https://dosja.al/aktualitet/rritja-e-cmimeve-te-banesave-u-frenua-ne-gjysmen-e-pare-te-2026-i515725` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 05:30:29 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 05:15:13 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d5aa9af60f677a942c7a6544e938a79907ad9846a970556291b7b66db88bc103` |
| TEKSTI | `e586625f532cab0db415052f3e04aa70ac7b8d957a4d2503035fdc4316a9927d` |
| PAMJA | `ac904d9dfb80de9187739457e54bac3763dad1503e7cbbc4d0d21e304c8c637c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4298ecfd08d0fb09577d57ed0aaecee5806f615bfa166cc1cdaf525d635a138f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `230958d0b4668d1bf0212a5d3815d620a5aafa95ae840eb14faf682fa1344cc0` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4298ecfd08d0fb09577d57ed0aaecee5806f615bfa166cc1cdaf525d635a138f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aktualitet

# Rritja e çmimeve të banesave u frenua në gjysmën e parë të 2026

Edhe ritmi i rritjes vjetore të çmimeve u ngadalësua ndjeshëm krahasuar me nivelet prej 28% të 6-mujorit të dytë 2025 dhe 41.7% të 6-mujorit të parë 2025.

dosja
24 Shtator 2026, 07:15
Nga E. D



foto ilustruese

**TIRANË-** Rritja e çmimeve të banesave u frenua në gjysmën e parë të këtij viti. Sipas informacionit nga Banka e Shqipërisë, Indeksi Fisher i çmimit të banesave mbeti i pandryshuar në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm, ndërsa u rrit me 10% në krahasim me një vit më parë.

Edhe ritmi i rritjes vjetore të çmimeve u ngadalësua ndjeshëm krahasuar me nivelet prej 28% të 6-mujorit të dytë 2025 dhe 41.7% të 6-mujorit të parë 2025.

Në mënyrë specifike për Tiranën, tregu shfaqi një ecuri më të mirë në terma 6-mujorë, me rritje të çmimeve me 10% krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2025, por një rritje më të dobët me bazë vjetore, me 9% krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit të kaluar.

Vlerësimi i përgjithshëm i agjentëve për situatën e përgjithshme të tregut ishte disi më pozitiv në krahasim me periudhën e kaluar.

Në përgjigje të pyetjes "Si e vlerësoni situatën e tregut në krahasim me periudhën (gjashtëmujorin) e mëparshme?", balanca neto e përgjigjeve ishte pozitive (+15%) me përgjigje veçanërisht optimiste për zonën e bregdetit, ku vlera e balancës ishte dukshëm më pozitive sesa mesatarja afatgjatë. I njëjti tregues i vlerësuar vetëm për subjektet që kanë raportuar shitje rezultoi ndjeshëm më pozitiv gjatë periudhës, me një balancë neto rreth 35%.

editoriale

Eriseld Zeneli
Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj
Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

AKTUALITET 23 SHTATOR 2026, 21:29
"Do të përfundojmë keq, shpirti im"/ Mediat greke: Mesazhet vënë në pikëpyetje marrëdhënien mes Hysenit dhe Agasit

AKTUALITET 23 SHTATOR 2026, 20:51
"Jo në emrin tim"/ Diaspora shqiptare në SHBA proteston para OKB-së në New York: Lironi heronjtë tanë! (VIDEO)

Në të njëjtën kohë, struktura e transaksioneve sipas diferencës ndërmjet çmimit të realizuar të shitjes dhe atij të kërkuar mbeti përgjithësisht e qëndrueshme, dhe çmimet me të cilat ndodhin transaksionet janë përgjithësisht të krahasueshme me çmimet e kërkuara nga shitësit e pronave.

Pjesa më e madhe e shitjeve vijoi të realizohej me çmime të njëjta ose deri në 5% më të ulëta sesa çmimi fillestar i kërkuar, ndërsa transaksionet me zbritje më të mëdha janë të rralla.

Numri i pronave të pashitura, si për banesa, ashtu edhe për godinat tregtare, ka vijuar të shënojë rënie për disa gjashtëmujorë radhazi.

Koha mesatare e shitjes së banesave në rang vendi u rrit lehtë në 9.9 muaj nga 9.1 muaj në vrojtimin e mëparshëm. Në rastin e Tiranës, koha mesatare e shitjes u rrit në 9.7 nga 8.1 muaj.

Koha mesatare për shitjet në zonat bregdetare u ul në 8.2 nga 9.9 muaj, ndërsa për zonat e tjera, kohëzgjatja e shitjes ishte shumë pak më e lartë sesa në gjashtëmujorin e kaluar, duke u rritur në 10.6 nga 10.1 muaj.

Financimi nëpërmjet kredisë bankare ka vijuar të figurojë në një pjesë të mirë të shitjeve të pronave. Sipas agjentëve, rreth 58% e pronave për banim dhe e atyre për përdorim tregtar të shitura prej tyre janë blerë me hua bankare. Nga këto, në 34% të rasteve, kredia ka mbuluar deri në 60% të vlerës.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të viti 2026, rreth 20% të banesave të shitura janë raportuar të blera nga shtetas jorezidentë. Nga këta, rreth 85% rezultojnë shtetas të vendeve të BE-së. Në tërësi, pesha e transaksioneve në të cilat blerësit janë jorezidentë ka shfaqur një prirje në rritje gjatë 5 vjetëve të fundit.

Pritjet për të ardhmen e subjekteve të anketuara paraqiten pozitive. Agjentët kanë pritje pozitive për ecurinë e tregut në territorin ku ata veprojnë për të ardhmen afatshkurtër dhe për periudhën më të gjatë (deri në dy vjet).

Informacioni mbi ecurinë e çmimeve dhe vlerësimin e situatës nga ana e agjentëve në tregun e pasurive të paluajtshme merret nëpërmjet vrojtimit në terren të një kampioni të përbërë nga 230 subjekte, që kanë si aktivitet kryesor tregtimin e pronave të paluajtshme.

Subjektet e zgjedhura janë agjentë të zyrave të tregtimit të pasurive të paluajtshme dhe shoqëri ndërtimi, shitjet e të cilave përfaqësojnë rreth 75%-80% të xhiros së të gjithë popullatës. Banka e Shqipërisë realizon hartimin e pyetësorit, si edhe hedhjen dhe përpunimin e rezultateve, ndërkohë që Instituti i Statistikave mbulon intervistimin në terren, proceset kryesore të kampionimit dhe kontrollin fizik të pyetësorëve të plotësuar./Monitor

banka e shqipërisë

AKTUALITET 23 SHTATOR 2026, 20:16

Dokumentari austriak për korrupsionin në Shqipëri/ Lindita Çela: Po kontrollohen faktet, ndodhet në proces editimi

## më të klikuarat

**Bomba tjetër për qeverinë Rama/ Prova e fakte se ku shkojnë paratë e zhvatura nga korrupsioni**

**"Nuk kam mbajtur marrëdhënie personale"/ Vlora Hyseni nxjerr bllof Ramën në bisedat me Agasin: Ika se do takoj KM**

**"Kështu janë infot…Tao shoku"/ Ish-kreu i SHISH fliste me Agasin dhe për politikë: Balla, kryetar Kuvendi**

**Prokuroria e Posaçme zbuloi 9 faqe me të dhëna sekrete të SHISH në makinën e Agasit, biznesmeni: I lash me qëllim që t'i gjente SPAK**

## insights

Rezarta Gagani

**Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat**

Auron Janku

**Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë**

Ola Xama

**Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen**

Idriz Konjari

**Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?**

## Sondazh

Poll

## Moti

Powered by tomorrow

Aktualitet

24 Shtator 2026, 07:13

# Ecja dhe shikimi, vështirësitë më të shpeshta të shqiptarëve; 28% raportojnë kufizime

foto ilustruese TIRANË- Më shumë se një në katër persona të moshës 16 vjeç e lart në Shqipëri rapo...

### Kushte të qëndrueshme atmosferike, parashikimi i motit për sot

Aktualitet

24 Shtator 2026, 07:10

### Plagosja me thikë në Tiranë, ndërron jetë 49-vjeçari

Aktualitet

23 Shtator 2026, 23:10

### VIDEO/ Bie zjarr në fushën e Lazaratit, digjet një sipërfaqe me barishte dhe shkurre

Aktualitet

23 Shtator 2026, 23:00

### Behajdin Allaqi/ Çfarë dihet për zhdukjen e tij dhe çfarë konstatoi Gjykata Speciale

Aktualitet

23 Shtator 2026, 22:53

Aktualitet

23 Shtator 2026, 22:50

# Plagosja me thikë në Tiranë, ja kush është autori i dyshuar

Foto ilustruese TIRANA- Autori i dyshuar i plagosjes me thikë, ngjarje e cila ndodhi pak minuta më parë në Tiranë është&n...

### Protesta në Prishtinë kundër vendimit të Hagës/ Mijëra qytetarë mbushin sheshin "Skënderbeu": Jo në emrin tim! (VIDEO)

Aktualitet

23 Shtator 2026, 22:45

---

### Plagosja me thikë në Tiranë, reagon policia: I dëmtuari ndodhet në spital, nën kujdesin e mjekëve

Aktualitet

23 Shtator 2026, 22:30

---

### Plagosja në Tiranë, arrestohet autori që goditi me thikë 49-vjeçarin

Aktualitet

23 Shtator 2026, 22:20

---

### "Kisha hajdutë në shtëpi, njëri ka vdekur"/ Publikohet telefonata e italianit pas vrasjes së shqiptarit: Jam i dëshpëruar, unë thjesht u mbrojta

Aktualitet

23 Shtator 2026, 22:10

**MË SHUMË**






Bie zjarr në fushën e Lazaratit, digjet një sipërfaqe me barishte dhe shkurre



Haga dënon Kosovën/ Pjesëmarrje masive në shesh, protestuesit për të tetën natë radhazi...



"Deputetë frikacakë, vetëm burgun keni hak"/ Protestuesit marshojnë para Parlamentit: Anuloni ligjet



Mbyllen fjalimet te Kryeministria/ Qytetarët nisin marshimin në rrugët e Tiranës: Ju erdhi fundi!

## Bie zjarr në fushën e Lazaratit, digjet një sipërfaqe me barishte dhe shkurre

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta

AKTUALITET

POLITIKE

Drejtor: Enton Abilekaj


ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDESUAR NGA Mediadesk

POLITIKE
EKONOMI
BOTA
SPORT
ART&ARGËTIM
INSIGHTS
EDITORIAL

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.